

Fakulteti: Fakulteti shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori lëndës, Mr. Emrush Xhemajli

Java

Njesia: LOJA DHE EDUKIMI I FEMIJEVE PARASHKOLLOR

a. Loja dhe edukimi intelektual i fëmijës parashkollor

Me edukimin intelektual nënkuptohet:

- fitimi i një sasive diturish dhe në saje të tyre formimi i botëkuptimit shkencor mbi botën;
- zhvillimin e aftësive mendore (formimi dhe pasurimi i fjalorit, të gjykuarit të pavaur logjik, konkludimi, zgjerimi i horizontit dhe njohja e së vërtetës objektive);
- Edukimi i kërshërisë (dormimi dhe zhvillimi i kureshtjes dhe ndjenjës së padurueshme për të mësuar e për të njohur diç të re);
- Dhe formimi i kulturës së punës. Në realizimin e këtyre detyrave tejet të ndërlikuara, loja zë një vend të rëndësishëm.

Për edukimin intelektual rol të rëndësishëm kanë:

- **Lojërat me rregulla;**
- **Kashelashet;**
- **Gjëgjëzat;**
- **Lojërat imituese (fëmija e luan rolin e edukatores të profesorit, mjekut, postierit, pilotit, etj);**
- **Lojërat për njohjen e ambientit etj.**

Fëmija gjatë lojës i zhvillon funksionet dhe aftësitë e llojllojshme. Me anën e lojës fëmija i fiton përvojat elementare mbi botën, e cila atë e rrethon. Ai duke luajtur shumë objekte e gjesende të ndryshme i kap me dorë, i vëzhgon, ua ndërron vendin, i ndanë dhe i palon etj. Gradualisht, fëmija duke i përdorur sendet e ndryshme gjatë lojës fillon t'i zbulojë ato cilësi, te

cilat kontribuojnë për të dalluar sendet e objektet. Ai duke lëvizur trupin e vetë gjatë lojërave fiton përvojën elementare mbi hapsirën. Nëpërmjet aktivitetit gjatë lojës mëson për t'i hetuar dhe dalluar atë që është e madhe, të shkurtën nga e gjagta etj. Këto dhe veprimet e ngjashme fëmijën e aftësojnë për të krahasuar dhe konkluduar. Fëmija, gjatë lojës vepron intensivisht me një durim të pashoq. E shpreh gëzimin ndaj krijimeve të veta gjatë lojërave creative.

Fëmija shpreh kënaësinë ndaj rezultateve të lojës, por shumë më tepër është i kënaqur kur të rriturit i ofrojnë pranim dhe lavdata për sukseset e arritura. Kësisoj tek fëmija rritet vetëbesimi dhe forcohen motive për për pjesëmarrje të mëtutjeshme në lojë. Kuptohet, se fëmija gjatë lojës, sikurse edhe gjatë punës, kacafytet me vështirësira dhe pengesa të ndrezshme, edhe pse, ai ato në njëfarë mënyre, di t'i zotërojë dhe kapërcejë. Ai gjatë lojës ka plotë situata të reja, ku nuk mjafton vetëm aplikimi mekanik i përvojave, por nga fëmija kërkohen për të zbuluar rrugë të reja. Në raste të tilla vjen në shprehje vetë inteligjenca e fëmijës.

b. Lojerat dhe edukimi moral e atdhedashës

Loja është mjet më efikas për realizimin e detyrave morale: për kultivimin dhe zhvillimin e ndjenjave morale:

- çiltërsisë, thënja e të vërtetës kundër gënjeshtërisë, aprovimin e të mirës dhe gjykimin e të keqes, të qenunit i drejtë në lojë
- të qenit i hapur kundër fshehjeve apo marrjes së objekteve që si përkasin pa pyetur,
- për zhvillimin e shprehive e të sjelljeve të mira;
- për zhvillimin e miqësisë dhe të shoqërimit,
- për zhvillimin e dashurisë për natyrën, për shoqërinë, për vendlindjen, për atdheun.

Loja e organizuar mirë dhe e orientuar për të realizuar detyrat e edukimit moral kontribuon dukshëm për zhvillimin e ndjenjave morale. Gjithashtu, formimi dhe zhvillimi i shprehive, i sjelljeve të mira te fëmijët etj, më së miri kryhet me anën e lojërave.

Vecanërisht lojërat me role mundësojnë imitim e punës së disa profesioneve (mjekut, edukatores, postieit, etj. Sidomos, imitimi

ifjalëve, gjestgeve, mimikës, veprimeve të atyre njërzëve dhe duke imituar të rriturit gjatë lojës, fëmijët i përvetësojnë sjelljet e tyre dhe kësaj fillojnë të formojnë shprehje për sjellje të mira ndaj shokëve të tyre, ndaj të rriturve në gjirin familjar.

Shprehjet e fituara më anë të imitimit të situatës jetësore janë rezultat i lojës dhe imitimit, por jo edhe rezultat i mësimdhënies, i qortimeve dhe i moralizimit.

Loja e matur, e organizuar dhe nxitëse është gjithnjë interesante për fëmijët. Prandaj vëmendja e fëmijës dhe aktiviteti i tij mund të zgjatin më tepër kur ai angazhohet në lojë. Fëmija në lojë përqëndrohet dhe në mënyrë të veçantë e përjeton të vërtetën dhe vetëveten. Në raste të tilla mund të paraqitet edhe rreziku që fëmija i paineresuar sa duhet, të jepet pas lojës aq shumë sa që ngel edhe i vetmuar duke luajtur. Rastet e këtilla paraqiten sidomos te fillestarët në entin parashkollor. Cdo edukatore e shkathtë përnjëherë do t'i hetojë fëmijët e tillë dhe duke i shoqëruar ata me fëmijët e tjerë. Në shumë raste, edukatorja së pari duhet të luajë bashkë me atë fëmijë.

Lojërat me grup fëmijësh kontribuojnë për edukimin moral (zhvillimin e miqësisë, të shoqërimit dhe të ndjenjës së përkatësisë kombëtare të fëmijëve). Lojërat në grupe edukojnë edhe socializimin e fëmijës.

c. Loja dhe edukimi estetik

Fëmija në rritën e tij vjen në kontakt me sende e objekte të lloj-llojshme. Ai me ato luan, manipulon, i ndan në pjesë (analizon), i bashkon pjesët e ndara në tërësi për të bërë një send ose një objekt (sintetizon), përpilon dhe kombinon gjërat e sende të reja.

Loja do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e kuptimit për të bukurën te fëmijët nëse secili ambient dhe çdo rreth ku gjendet fëmija është vërtetë i përshtatshëm dhe me një klimë të përshtatshme educative. Andaj, ambienti ku edukohet fëmija duhet të shndërrohet në ambient optimal estetik. Gjithashtu, lodrat me të cilat luajnë fëmijët duhet t'i plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me vlerën e njëmendtë pedagogjike dhe

estetike të tyre. Kësisoj, pa dushim, kontribuohet për të krijuar kushte themelore të edukimit estetik të fëmijëve parashkollor.

Lojërat ndikojnë në zhvillimin e kuptimit për të bukurën, veçmas dramatizimet dhe lojërat e fëmijëve me kukulla, që mshteten në tekstin e bukur dhe artistik, janë forma ndihmëse të zëvendësueshme për të zhvilluar kuptimin për te folurit e rrjedhshëm, shprehës e të bukur.

Në shumë raste mund të organihohen lojëra ku fëmija ndërton dhe vizaton, ose edhe lojëra të tjera shoqërore, të cilat përcillen me muzikë. Edhe muzika ndikon që te fëmija të formojnë kuptimin për të shprehurit e bukur muzikor.

Këto dhe shumë lloje të tjera të lojërave ndikojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm të mundësive të trashëguara (të lindura) për krijimtari (kreativitet) të fëmijës në lëmin e artit figurative, muzikor, letrar, vallëzues, si dhe të shprehjes së interpretimit recitues të fëmijëve. Kreativiteti I fëmijës parashkollor është e mundur të nxitet me anën e lojërave të llojllojshme, e sidomos nëpërmjet këtyre lojërave:

- Loja me role (tetari I kukullave, kinemaja, cirku, etj).
- Loja e të kënduarit;
- Loja me instrumente të ndryshme;
- Loja me vjersha;
- Lojërat vallëzuese;
- Lojërat me leximin e ilustrimeve dhe të librave për fëmijë;
- Valet popullore
- Tetari I kukullave
- Dramatizimet e lira, etj.

KUKULLA

Kukulla është mjet më i rëndësishëm për zhvillimin e tërësishëm të fëmijës. Fëmija thajse identifikohet me kukullën. Ai atë ë konsideron shok e anëtar të famijes. Ajo fëmijës ia largon frikën dhe atë ë mëson “të flaës” e “të këndojë”. Fëmija me kukullën shpreh

edhe forcon ndjenjat. Kukulla fëmijës i mundëson të jetë i afërt me njerëzit e tjerë. Fëmija me kukullën komunikon, manipulon, krahason, u ofrohet njerëzve, pra fëmija zhvillohet me anën e kukullës.

Gjatë zhvillimit të kreativitetit të fëmijët, edukatorja duhet të ketë parasyshë se gati të gjithë krijuesit e mëdhenjë nuk janë konvencional por janë, parasegjithash, tejet të hapët e të sinqeretë në lirinë e të shprehurit të vet.

Së këtejme, edukatorja duhet ta nxitë e ta ushqejë sinqeritetin dhe spontanitetin e fëmijës, me qëllim që fëmija edhe kur të rritet të jetë më i çiltër dhe sa më i lirë në punën e vet krijuese.

d. Loja dhe edukimi fizik

Edhe pse loja si mjet për edukimin fizik shfrytëzohet më së tepërmi, ajo nuk është edhe e vetmja mënyrë e formë e edukimit fizik. Në zhvillimin trupor të fëmijës ndikon organizimi i përgjithshëm i jetës dhe i punës së fëmijës në entet parashkollore. Loja duhet të oirganizohet e të realizohet si mjet edukativ, në rastin kur tubohen fëmijët pastaj gjatë aktiviteteve të lira, aktiviteteve të orientuara, gjatë shëtitjeve dhe daljeve në natyrë, gjatë përgatitjeve të hapsirës dhe lokaleve në entin parashkollor, përgatitjes për drekë, fjetjes e të tjera.

Gati secila lojë, e cila fëmijëve ua angazhon fuqitë fizike, ndikon edhe në zhvillimin trupor, nëse fëmijët gjatë dramtizimit imitojnë, bëjnë gjeste e të tjera.

Megjithatë, për edukimin fizik dhe zhvillimin trupor të fëmijës në moshën parashkollore, sidomos për zhvillimin e pjesëshëm të organeve të trupit të fëmijës organizohen lojëra të veçanta, si p.sh. lojërat e shkathtësisë, lojërat e qëndrushmërisë e të tjera.

e. Loja dhe edukimi punues

Edukimi moral dhe punues plotësohen me njëri tjetrin. Orientimi I lojës për të formuar qëndrim emocional ndaj punës te fëmija ka të bëjë më tepër me edukimin moral të tij. Mirëpo, loja kërkon edhe parasupozon kryerje të disa operacioneve të caktuara të punës, me të cilat arrihet rezultatet e lojës. Kjo karakteristikë e lojës e orienton fëmijën në punë dhe për qëndrueshmëri në punë. Megjithatë, loja është një formë tejet interesante e aktivitetit të fëmijës.

Edukatorja duhet ta zhvendosë interesimin e fëmijës nga loja në punë. Edukatorja duhet t'i zgjedhë momentet që edhe gjatë punës t'ia mësojë fëmijës lojën.

Marrëdhëniet interpersonale të fëmijës në lojë dhe njohja e ndërsjellë e punës, kontribuon për të arritur rezultate të mëdha pune ndërsa kjo gjë u mudëson fëmijëve t'i çmojnë e t'i respektojnë rezultatet e punës së vetë dhe ato të punës së tjerëve.

Fëmijët, duke luajtur i zotërojnë operacionet e caktuar të punës. Ata njihen me shumë profesione dhe vegla pune. Loja kontribuon për angazhimin e aftësive trupore dhe mendore të fëmijës dhe kështu ndikon për ta penguar krijimin e paragjykimeve për dallimet ndërmjet punës intelektuale dhe punës fizike.